Kronikë

Lezhë/ Lëvizte i armatosur dhe me automjet pa targa, pranga 30-vjeçarit

I riu u kap teksa po lëvizte me një automjet tip "Fiat", pa targa, në fshatin Shënkoll. Në gjendje të lirë do të hetohen edhe Klisman Ndou dhe Admir Alija.

Redaksia
22 Dhjetor, 14:51 | **Përditesimi: 22 Dhjetor, 15:09**

Share

Lezhë- Policia e Lezhës ka goditur një tjetër rast të armëmbajtjes pa leje. Në pranga ka rënë një 30-vjeçar i identifikuar si Kristian Buzatu.

I riu u kap teksa po lëvizte me një automjet tip "Fiat", pa targa, në fshatin Shënkoll. Gjatë kontrolleve të kryera blutë gjetën 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, të cilën e mbante pa leje.

Ndërkohë në gjendje të lirë do të hetohen edhe Klisman Ndou dhe Admir Alija, pasagjerët në makinën e 30-vjeçarit.

LEXO EDHE:
Lezhë/ Legalizuan kompleksin pa leje te Rana e Hedhun, Apeli ashpërson masat për 5 zyrtarë! Arrest në burg për ish-kreun e ASHK, Gentian Malotajn

Njoftimi i policisë:

Si rezultat i administrimit të menjëhershëm të një informacioni të siguruar në rrugë operative, për një shtetas që lëvizte i armatosur, shërbimet e Seksionit të Mbështetjes Operacionale finalizuan operacionin "Gjerdani".

Në kuadër të operacionit u ndalua në mbrëmje, teksa drejtonte një automjet tip "Fiat", pa targa, në fshatin Shënkoll, shtetasi i dyshuar, K. B., 30 vjeç, banues në Lezhë. Gjatë kontrolleve, 30-vjeçarit iu gjet në çantë, 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, të cilën e mbante pa leje.

Në vijim të veprimeve procedurale për rastin nisi procedimi penal, për veprën "Moskallëzimi i krimit", për 2 pasagjerët në automjetin që drejtonte shtetasi K. B., shtetasit A. A., 30 vjeç, banues në Durrës, dhe K. N., 25 vjeç, banues në fshatin Tale.

Materialet procedurale iu refruan Prokurorisë së Lezhës, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/I.M/Shqiptarja.com

TAG: Admir Alija | Klisman Ndou | armembajtje pa leje | Lezhe | Kristian Buzatu

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 22 Dhjetor, 10:22
Klodian Braho merr zyrtarisht detyrën, prisni ndryshim në punën e SPAK?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Lezhë/ Qytetari hedh thesin me mbeturina në anë të rrugës, kryebashkiaku Ndreu: Turp (VIDEO)
22 Dhjetor, 09:58

Aksident i dyfishtë në Lezhë-Shkodër, 2 të plagosur! Njëra nga automjetet përfundon në parcelë (VIDEO)
21 Dhjetor, 15:22

Në prag të festave të fundvitit, tregu i Lezhës i boshatisur! Shkak rritja e çmimeve
Elvis Hila
21 Dhjetor, 14:49



Qarkullonte me armë dhe municione luftarake në makinë, arrestohet 35-vjeçarja në Mirditë
21 Dhjetor, 09:05

Berisha nga Kurbini: Balluku 300 apartamente dhe dy jahte me paratë e vjedhura! Rama është armik i shqiptarëve, me të s'ka zgjedhje të lira
20 Dhjetor, 18:35

Transformimi i Kishës së Laçit, besimtarët në protestë! Këshilli i territorit s'ka dhënë ende lejen për projektin
Elvis Hila
20 Dhjetor, 17:14

Kullat e Lezhës drejt rijetëzimit, 200 prej tyre pjesë e programit kombëtar për restaurim dhe zhvillim turistik
Elvis Hila
20 Dhjetor, 10:45

Lezhë/ Përplasen dy mjete në kryqëzimin e Gjadrit, plagosen 2 persona
19 Dhjetor, 19:13

Plagosja me armë zjarri në Mamurras, identifikohen dy autorët 18-vjeçar (EMRAT)
18 Dhjetor, 11:12

Aksident në aksin Lezhë–Milot, mjeti përplas të moshuarën teksa po kalonte rrugën
17 Dhjetor, 18:04

Lezhë, krijimtaria më e mirë e Pashk Përvathit me 82 piktura tashmë në një galeri të re arti
Elvis Hila
17 Dhjetor, 17:25

Lezhë/ I riu qëllon me armë 50- vjeçarin, shkak xhirimi i gomave të mjetit, në kërkim autori
17 Dhjetor, 17:14

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje